



BASHKIA PATOS

RAPORTI I PERFORMANCËS

2019

DISCLAIMER

Raporti i performancës bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Patos gjatë vitit 2019 “**miratuar në Këshillin Bashkiak**”.

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Patos me asistencën e Projektit Bashki të Forta dhe Smart Processes.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

BASHKIA PATOS



Patosi është një bashki e vogël me një qytet industrial relativisht të ri, por me një histori e cila humbet në thellësinë e shekujve, ku ndërthuren traditat e Krahinave të Myzeqesë dhe Mallakastrës. Pasuritë natyrore kanë orientuar ekonominë e Bashkisë drejt sektorit primar dhe industrisë së hidrokarbureve, duke krijuar një pol të rëndësishëm në rang kombëtar. Zhvillimi i ardhshëm orienton bashkëjetesën e industrisë me bujqësinë, duke strukturuar vendbanimet, rritur cilësinë e jetës, dhe shtuar aktivitetet për t'i shërbyer popullsisë të rajonit të Fierit


ORIENTIM AFATGJATË

Elementët e fortë territoriale, pikat e forta në kapitalin njerëzor dhe ekonomik do jenë themelet e strategjisë së zhvillimit të ardhshëm të territorit. Në zhvillimin e ardhshëm të territorit janë përcaktuar 3 drejtime kryesore të zhvillimit: Zhvillimi ekonomik, Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve, Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe ambientale.

TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME 2019

PROFILI

Popullsia



3 njësi administrative

83 km²
sipërfaqe

BASHKIA PATOS


Kryetari i Bashkisë



Rajmonda Balilaj

Këshilli i Bashkisë

21 anëtar



Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

- Të Ardhura Buxhetore prej Burimeve të veta tregojnë kapacitetin financiar të bashkisë dhe përfshijnë përveç taksave, tarifave, të ardhurave të tjera nga asetet dhe donacionet edhe të ardhurat e trashëguara nga një vit më parë.
- Të ardhurat nga QQ përfshijnë transfertat e pakushtëzuara të ministrisë së financave, transfertat e kushtëzuara për projekte të caktuara të ministrive të linjës dhe FZSHH si edhe transfertat të qeverisë qendrore për funksione të deleguara apo specifike.
- Programet buxhetore janë ato zëra të shpenzimeve të buxhetit të cilat financojnë funksionet ligjore të bashkisë të cilat janë funksione të veta ose funksione të deleguara nga qeveria qendrore.
- Treguesit kyc financiarë – llogaritja dhe domethënia e tyre

- **Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave** = Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave, me pak ndryshime – raporti tregon sesa shpenzon njësia për të ofruar një Lek shërbime publike
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave** = Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Kujtojmë që në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara nga viti kaluar. Një raport i lartë është pozitive për njësinë pasi tregon se njësia nuk mbështetet në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave** = Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Kujtojmë që në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara nga viti kaluar. Një raport i lartë është pozitive për njësinë pasi tregon se njësia nuk mbështetet në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)
- **Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave** = tregon kapacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerohet jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta.
- **Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifat vendore ndaj planit të tyre** = Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përheshme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave
- **Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve** = Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore
- **Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve** = Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- **Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave** = huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një raport / normë e ulët tregon se bashkia është e aftë ta paguajë borxhin (principal + interesin) sipas afatit të caktuar, një normë e lartë mund të sygjerohet se bashkisë do ti duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin
- **Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave** = Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- **Norma e shpenzimeve për politikave sociale ndaj totalit të shpenzimeve** = Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.



Përmirësim



E njëjta situatë



Përkeqësim

NI Nuk ka informacion

INFORMACION MBI SHPENZIMET

Realizim i shpenzimeve operative

Shpenzimet operative janë planifikuar 104,744 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 81,585 mijë lekë, ose 78 % e planit për shpenzime operative. Në mos realizimin e shpenzimeve operative ka ndikuar shpërndarja e shërbimeve sipas rregjistrit të parashikimeve, aktivitetet kulturore në muajt e fundit të vitit, përdorimi i kufizimit të cash-it.,

Realizim i shpenzimeve kapitale

Investimet janë planifikuar në vlerën 241,808 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 183,957 mijë lekë ose 76 % e planit për shpenzime kapitale. Për sa i përket realizimit ka ndikuar periudha e zbatimit të investimeve kryesore në muajt e fundit të vitit dhe kufizimi i përdorimit të cashit.

Realizim i shpenzimeve të personelit

Shpenzimet për paga dhe sigurime sipas buxhetit 2019 për 12-mujorin janë planifikuar në vlerën 221,513 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 202,512 mijë lekë ose 91 % e planit për shpenzime personeli.


Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet buxhetore sipas programe buxhetore të përdorura nga bashkia.

Fakt 2017	Buxheti i shpenzuar nga bashkia për secilin program buxhetor në vitin 2017
Fakt 2018	Buxheti i shpenzuar nga bashkia për secilin program buxhetor në vitin 2018
Plan 2019	Buxheti i planifikuar nga bashkia për secilin program buxhetor në buxhetin e vitit 2019
2019 vs 2018	Ndryshimi i buxhetit të shpenzuar nga bashkia në vitin 2019 kundrejt atij të shpenzuar në vitin 2018 në përqindje
Fakt 2019 vs Plan 2019	Përqindja faktike e realizimit të buxhetit kundrejt planit të vitit 2019

SHPENZIMET BUXHETORE

SHPENZIMET SIPAS 13 PROGRAMEVE BUXHETORE TË PËRDORURA NGA BASHKIA						
1'000 LEK	FAKT 2017	FAKT 2018	PLAN 2019	FAKT 2019	2019 vs 2018	FAKT 2019 vs PLAN 2019
Projekte Zhvillimi	58,738	105,461	171,121	130,179	23.4%	76.1%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	71,055	99,915	94,157	80,998	-18.9%	86.0%
Sherbime publike vendore (Ndërmarrja e mirëmbajtjes urbane)	43,365	46,003	86,462	78,898	71.5%	91.3%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	48,275	48,266	61,267	55,235	14.4%	90.2%
Menaxhimi i mbetjeve	25,819	26,108	33,336	30,890	18.3%	92.7%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	21,977	22,365	31,954	25,595	14.4%	80.1%
Programet e zhvillimit (Ndërmarrja e Gjellbërimit)	11,492	15,344	18,151	17,612	14.8%	97.0%
Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile	10,425	17,342	20,814	14,456	-16.6%	69.5%
Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	14,314	5,917	19,791	11,462	93.7%	57.9%
Sport dhe argëtim	13,485	13,680	11,393	10,523	-23.1%	92.4%
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	3,331	3,003	11,757	7,532	150.8%	64.1%
Rrjeti rrugor rural	991	1,149	3,943	3,665	219.0%	92.9%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	3,499	3,019	3,920	3,009	-0.3%	76.8%
TOTALI	326,766	407,572	568,066	470,054	15.3%	82.7%

ILUSTRIM PËR SHPENZIMET



Shënim: Në vijim të planit të performancës 2020 – 2022, me qëllim ruajtjen e koherencës së treguesve të performancës dhe programeve buxhetore, si dhe për të ofruar një kuptueshmëri të qartë të realizimit të funksioneve të bashkisë, raporti i performancës ka ruajtur të njëjtën strukturë raportimi buxhetor si ai i planit i performancës 2020 - 2022

SHPENZIMET ME FONDE JASHTË BUXHETIT

FONDET	Shpenzime personeli		Shpenzime operative+të tjera		Shpenzime kapitale		TOTALI		NË %	NË %	NË %
	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT			
FONDE NGA MARS/FZHR											
Rikonstrukcion Shkolla Meleq Gostnishti + M.Matohiti					63,781	63,781	63,781	63,781	100	0	0
Adaptim i ish-Godines se kualifikimit,ne banese sociale					10,043	10,037	10,043	10,037	100	1	1
SHUMA 1	0	0	0	0	73,824	73,818	73,824	73,818	100	0	0
FONDE TË DELEGUARA											
Fonde PAAK + ND Ekonomike			162,362	162,362	-	-	162,362	162,362	100	0	0
Gjendja Civile/KZAZ	5,472	5,472	327	327	-	-	5,799	5,799	100	2	2
SHUMA 2	5,472	5,472	162,689	162,689	0	0	168,161	168,161	100	0	0
TOTAL FONDE JASHTË BUXHETIT	5,472	5,472	162,689	162,689	73,824	73,818	241,985	241,979	200	0	0


BURIMET E FINANCIMIT

BURIMET						
1'000 LEK	FAKT 2017	FAKT 2018	PLAN 2019	FAKT 2019	2019 vs 2018	FAKT 2019 vs PLAN 2019
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	153,560	174,328	203,746	216,894	24.4%	106.5%
Të ardhura nga taksat lokale	53,039	54,831	146,290	139,519	154.5%	95.4%
Të ardhura nga taksat e ndara	57,556	68,626	1,217	1,902	-97.2%	156.3%
Të ardhura nga tarifa vendore	41,182	48,115	53,539	44,506	-7.5%	83.1%
Të ardhurat e tjera	1,783	2,756	2,700	30,966	1023.6%	1146.9%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	201,716	185,143	218,903	219,775	18.7%	100.4%
Transferta e pakushtëzuar	125,348	122,464	138,431	138,431	13.0%	100.0%
Transferta e kushtëzuar	0	0	0	0	NI	NI
Trasferta specifike	76,368	62,679	80,472	81,344	29.8%	101.1%
HUAMARRJA	0	0	0	0	-	-
Huamarrja afatshkurtë	0	0	0	0	-	-
Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	-	-
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	138,168	168,092	144,542	144,542	-14.0%	100.0%
Trashëgimi pa destinacion	124,018	155,079	119,459	119,459	-23.0%	100.0%
Trashëgimi me destinacion	14,150	13,013	25,083	25,083	92.8%	100.0%
TOTAL BURIME FINANCIARE	493,444	527,563	567,191	581,210	10.2%	102.5%

BURIMET E FINANCIMIT NË VITIN 2019


ANALIZA E TE ARDHURAVE

Sic shihet edhe nga tabela e mëposhtme për Bashkinë Patos, të ardhurat e përgjithshme janë realizuar në masën 216,895 mijë lekë, kundrejt planit të buxhetit prej 203,746 mijë lekë. Pra kemi një realizim të planit 12-mujor në masën 106.4 %, një tejkalim me 6.4 %. Vëmendje i është kushtuar realizimit dhe arritjes së të ardhurave të planifikuara, pasi nga realizimi i tyre varet edhe kryerja e shërbimeve dhe investimeve të ndryshme që ka në prioritet Bashkia jonë. Realizimi i të ardhurave në masën 106.4 % ka ndikuar në buxhetin 2019. Duke marrë parasysh situatën, Bashkia ka menaxhuar shpërndarjen e të ardhurave në bazë të prioriteteve dhe objektivave si në Administratë edhe në Ndërmarrjet e vartësisë. Në zbatim të buxhetit 2019 dhe duke u dhënë prioritetet shërbimeve në komunitet. Në fund të viti buxhetor kemi trashëguar nga të ardhurat një vlerë prej rreth 55 milion lekë, të cilat do të përdoren gjatë vitit 2020.




- TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA
- TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR
- HUAMARRJA
- TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR

TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA




- Të ardhura nga taksat lokale
- Të ardhura nga taksat e ndara
- Të ardhura nga tarifa vendore
- Të ardhurat e tjera

TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR




- Transferta e pakushtëzuar
- Transferta e kushtëzuar
- Trasferta specifike

TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR



- Trashëgimi pa destinacion
- Trashëgimi me destinacion



NDRYSHIMI KUNDREJT VITIT PARARDHËS

↑ **24.4%** BURIMET E VETA TË FINANCIMIT

↑ **18.7%** TË ARDHURA NGA BUXHETI QËNDROR

↓ **-14.0%** TRASHËGIMIA E VITIT TË SHKUAR

= TË ARDHURAT NGA HUAMARRJA

PESHA E SHPENZIMEVE BUXHETORE SIPAS PROGRAMEVE NË RAPORT ME TOTALIN E SHPENZIMEVE

PROGRAMET NË RAPORT			
Programe	Raporti kundrejt total 2017	Raporti kundrejt total 2018	Raporti kundrejt total 2019
Projekte Zhvillimi	18%	25.9%	27.7%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	21.7%	24.5%	17.2%
Sherbime publike vendore (Ndërmarrja e mirëmbajtjes urbane)	13.3%	11.3%	16.8%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	14.8%	11.8%	11.8%
Menaxhimi i mbetjeve	7.9%	6.4%	6.6%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	6.7%	5.5%	5.4%
Programet e zhvillimit (Ndërmarrja e Gjellbërimit)	3.5%	3.8%	3.7%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	3.2%	4.3%	3.1%
Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	4.4%	1.5%	2.4%
Sport dhe argëtim	4.1%	3.4%	2.2%
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	1%	0.7%	1.6%
Rrjeti rrugor rural	0.3%	0.3%	0.8%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	1.1%	0.7%	0.6%

PROGRAMET NË FOKUS TË BASHKISË

Projekte Zhvillimi
27.7%


Planifikimi Menaxhimi
dhe Administrimi
17.2%

Sherbime publike vendore
(Ndërmarrja e
mirëmbajtjes urbane)
16.8%

Arsimi bazë përfshirë
arsimin parashkollor.
11.8%



SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK



	2017	2018	2019
■ Shpenzime Korente	291,693	267,139	284,097
■ Shpenzime Kapitale	35,073	140,433	185,957
Total Shpenzime	326,766	407,572	470,054

TRENDI I INVESTIMEVE

RRITJE E INVESTIMEVE GJATË
VITIT 2019



RRITJE E INVESTIMEVE
NË VITIN
2018 KUNDREJT 2017



PROGRAMET MË TË MBËSHTETURA ME INVESTIME



Projekte Zhvillimi
68.7 %



Sherbime publike
vendore (Ndërmarrja e
mirëmbajtjes urbane)
16.3 %



Planifikimi Menaxhimi
dhe Administrimi
5.1 %




Arsimi bazë përfshirë
arsimin parashkollor.
3.8 %

PROJEKTET KRYESORE TË INVESTIMEVE TË REALIZUARA NGA BASHKIA

Projekti	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projekti	Buxheti 2019	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	% e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019)	Komente
Rikonstruksion rr.Koli Marku	71,214	2018	2019	-	36,806	71,210	193%	Përfunduar
Rikonstruksion Shkolla Meleq Gostnishti	61,344	-	-	-	35,869	61,140	170%	Përfunduar
Rikonstr.Shkolla Mustafa Matohiti	85,965	2019	-	-	-	27,912	-	Në proces
Blerje asfalto beton nga 2018/Blerje rere bitumonoze	14,755	2019	2019	-	14,755	14,711	100%	Përfunduar

PESHA E INVESTIMEVE SIPAS PROJEKTEVE NE VITIN 2019




TREGUESIT FINANCIAR


TREGUESIT

SITUATA FINANCIARE


Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave




Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave




Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave




Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit tëshpenzimeve



Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale



Normal e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve



Bashkia ka financuar 13 programe buxhetore përkatëse të ndara në 7 funksione të saj ligjore:

Shërbimet e Përgjithshme Publike

01110-Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Rendi dhe Siguria Publike

03280-Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Çeshtjet Ekonomike

04240-Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit

04220-Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve

04520-Rrjeti rrugor rural

04740-Projekte Zhvillimi

Mbrojtja Mjedisore

05100-Menaxhimi i mbetjeve

Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit

06260-Sherbime publike vendore

06210-Programet e zhvillimit

Argëtimi, Kultura dhe Feja

08130-Sport dhe argëtim

08220-Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Arsimi

09120-Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.

09230-Arsimi i mesëm i përgjithshëm

01 Shërbimet e Përgjithshme Publike

Programet buxhetore:



01110 Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi



Ky program zë 17.2% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për personelin, shërbime të përgjithme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjetesh, zyra të printimit dhe IT etj., shpenzime për ofrimin e shërbimeve që mbështesin veprimtarinë e kryetarit, këshillit dhe komisioneve të këshillit, bazat e të dhënave vendore apo shërbime që lidhen me prodhimin dhe përhapjen e informacionit publik.

PËRSHKRIM REALIZIMI

Ky program menaxhon 17 % të totalit të buxhetit të bashkisë. Planifikim menaxhim administrim, fondin rezervë, emergjencën dhe kontigjencën, transferimin e kuotës së Këshillit të Qarkut/Shoqatave të Bashkive. Aparati i bashkisë funksionon me programin “Administrata Vendore” me kod 01110, i cili mbulon shërbimet mbështetëse për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose këshillin. Siguron planifikimin e zhvillimit të njësisë, menaxhimin e financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera të njësisë dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun. Aparati i Bashkisë në total menaxhon 45% të buxhetit 2019 i cili ka të bëjë me Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe menaxhimin (përfshirë këtu fondin rezervë dhe fondin e emergjencave), transferimin ndaj Këshillit të Qarkut. Realizimi i shpenzimeve të 12 muorit të vitit 2019, paraqitet në masën 91,539 mijë lekë ose 23 % të planit të buxhetit për këtë program, Bashkia Patos (aparati administrativ. Në këtë program janë përfshirë edhe punonjësit e policisë bashkiake, inspektoriat ndërtimor, sektori i auditimit, i prokurimeve publike, Drejtoria e Të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Urbanistikës, e Legjislacionit dhe Burimeve Njerëzore, e Financës. Brenda 3-mujorit të parë 2019 janë likuiduar në masën 100% detyrimet e trashëguara nga viti 2018 të cilat janë vetëm faturat e muajit dhjetor 2018, që me rregull likuidohen në muajin pasardhës. Duhet theksuar fakti se cdo detyrim i lindur ndaj të tretëve është likuiduar brenda afatit ligjor 30 ditor. Mbështetur në rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike vlen të përmendet se nuk ka shtyrje afatesh për prokurimin e programeve buxhetore. Plani 12 muor i të ardhurave është parashikuar që të realizohet në masën 100%, por është realizuar në masën 106.4%. Bashkia ka zhvilluar 11 aktivitete dhe sesione informimi, si Këndi i BE-së me qëllim rritjen e njohurive për procesin e integritetit, demokracinë lokale dhe promovimin e parimit të pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve në nivel lokal. (Afërsisht 300 të rinj dhe qytetarë të anagzhuar drejtpërdrejt në këto aktivitete (mbulimi financiar i jashtëm, asistencë nga “Bashkitë për në Europë”).

01110-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	42,540	71,400	83,422	71,529	0.2%	85.7%
Kapitale	28,515	28,515	10,735	9,469	-66.8%	88.2%
Total	71,055	99,915	94,157	80,998	-18.9%	86.0%

PROJEKTET E PROGRAMIT

Projekte me financim të brendshëm:

Projekti	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projekti	Buxheti 2019	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	% e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019)	Komente
Pajisje mobilje kompjuterike per ONE STOP SHOP	9,517	-	-	9,517	-	9,469	99.5%	

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Sistem informatik për taksat vendore “tais”, akses online për taksapaguesit2 (program i mirëmbajtur dhe në përmirësim)	1	1	1	100.0%
Sistem informatik për financat vendore “fais”1 (program i mirëmbajtur dhe në përmirësim)	1	1	1	100.0%
Qytetarë që marrin shërbime nga bashkia	800	800	960	120.0%
Shërbime administrative që ofrohen për qytetarët nga bashkia	67	67	67	100.0%
Punonjës të bashkisë në total	263	263	255	97.0%
Punonjës që janë larguar brenda vitit	30	27	33	122.2%

Numri i konsultimeve me publikun	16	14	16	114.3%
Persona të trajnuar në total	65	70	75	107.1%
Pjesa e bizneseve që i paguajnë taksat vendore	90	90	90	100.0%
Pjesa e qytetarëve që i paguajnë taksat vendore	60	60	60	100.0%
Përfitues nga ndihma PAK dhe ndihma ekonomike¹		162,362	162,362	100.0%

1. Shpenzimet për ndihmën për PAK dhe ndihmën ekonomike mbulohen nga fondet e deleguara nga Qeveria Qendrore



QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e kapacitetit të punonjësve të bashkisë(Raporti në % mes punonjësve të trajnuar dhe punonjësve total)	24.7%	26.6%	29.4%		111%
Rritja e qëndrueshmërisë së administrates civile(Numri i punonjësve që kanë qëndruar në punë kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në % i qëndrueshmërisë))	88.6	89.7	87		97%


QELLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Rritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarrje

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Konsultime me publikun(Numri i konsultimeve me publikun)	16	14	14		100%

QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i shërbimeve administrative

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Shërbime administrative që ofrohen nga bashkia për qytetarët(Numri i qytetarëve që marrin shërbime nga bashkia mesatarisht në një muaj)	800	800	960	↑	120%
Rritja e llojeve të shërbimeve të ofruara nga bashkia(Numri i llojeve të shërbimeve administrative që marrin qytetarët)	67	67	67	=	100%

QELLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Krijimi i një institucioni eficient të dixhitalizuar

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Realizimi në 100% i dixhitalizimit të taksat vendore, lidhje online me BND dhe ofrim i shërbimit ndaj taksapaguesve në mënyrë elektronike(Sistem informatik për taksat vendore, akses online për taksapaguesit)	100	100	100	=	0%
Realizimi në 100% i dixhitalizimit të financave vendore(Sistem informatik për financat vendore)	100	100	100	=	100%

QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i menaxhimit të burimeve financiare

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e mbledhjes së taksave vendore(Raporti në përqindje i bizneseve që paguajnë taksat vendore kundrejt numrit total të bizneseve)	90%	90%	90%	=	100%
Rritja e mbledhjes së taksave vendore(Raporti në përqindje i qytetarëve që paguajnë taksat vendore kundrejt numrit total të qytetarëve)	60%	60%	60%	=	100%

03 Rendi dhe Siguria Publike



Programet buxhetore:



03280 Mbrotja nga zjarri dhe mbrotja civile

Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile



Ky program zë 3.1% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për të siguruar funksionimin e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimit në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

PËRSHKRIM REALIZIMI

Në transfertën specifike të vitit 2019, janë fondet për Programin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Emergjencat Civile me një vlerë totale 20,814 mijë lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative e kapitale. Përpos realizimit të gjithë produkteve në masën 100%, Bashkia Patos, ka ofruar ndihmë gjatë tërmetit të Durrësit për rreth 72 orë me ekipin e saj zjarrfikës.

03280-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	5,145	12,062	15,582	14,456	19.8%	92.8%
Kapitale	5,280	5,280	5,232	0	0%	0%
Total	10,425	17,342	20,814	14,456	-16.6%	69.5%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Trajnime për fikjen e zjarrit dhe shpëtimit (ditë/vit)	2	2	20	1000.0%
Takime sensibilizuese të drejtuesve të institucioneve, kryepleq për mzsh	6	6	6	100.0%
Mësime treguese për përballimin e rasteve të zjarrit në shkolla, institucione publike, etj	20	20	20	100.0%
Certifikata për mzsh për subjektet private dhe shtetërore	150	150	150	100.0%
Numri i autobotëve	0	1	1	100.0%
Numri i automjeteve	1	1	1	100.0%
Numri i zjarrfikëseve	1	2	2	100.0%
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit	88	88	102	115.9%
Numri i stacioneve mzsh	1	1	1	100.0%
Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	14	14	14	100.0%
Koha e daljes nga stacioni (në sekonda)	20	20	20	100.0%
Sipërfaqja e mbuluar me shërbimin e fikjes së zjarrit dhe shpëtimit (në km2)	82.5	82.5	82.5	100.0%
Numri i zjarrfikësve	8	8	8	100.0%

QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit, permbytjeve dhe fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve për shpëtim

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i shërbimeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e sensibilizimit në komunitet për MZSH(Numri i takimeve për sensibilizim të drejtuesve të institucioneve, kryepoleq për MZSH)	6	6	6	=	100%
Certifikata për Mzsh për subjektet private dhe shtetësore(Numër certifikatash)	150	150	150	=	100%
Rritja e sipërfaqes së mbuluar me shërbim për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimit(Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit ndaj sipërfaqes totale të bashkisë)	100%	100%	100%	=	100%
Rritja e ndërgjegjësimit dhe përgatitjes në institucione për rastet e zjarreve dhe shpëtimit(Mësime treguese për përballimin e rasteve të zjarrit në vit)	20	20	20	=	100%

Koha e daljes nga stacioni(Koha e daljes nga stacioni (në sekonda))	20	20	20	=	100%
---	----	----	----	---	------

QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit, permbytjeve dhe fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve për shpëtim

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i kushteve dhe infrastrukturës në funksion të MZSH

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Numri i banorëve për zjarrfikës(Raporti i numrit të banorëve ndaj numrit të zjarrfikësve (banorë për 1 zjarrfikës))	5,342	5,342	5,342	=	100%
Rritja e kapaciteteve të punonjësve zjarrfikës(Numri i trajnimeve për fikjen e zjarrit dhe shpëtimit (ditë/vit))	2	2	20	↑	1000%
Numri i makinave zjarrfikëse(Numri i makinave zjarrfikëse)	1	2	2	↑	100%
Stacione MZSH(Numri i stacioneve MZSH)	1	1	1	=	100%

Numri i zjarrfikësve kundrejt numrit total të punonjësve MZSH(Numri i zjarrfikësve kundrejt numrit total të punonjësve MZSH (në %))	57.1%	57.1%	57.1%	=	100%
Sipërfaqe e mbuluar me shërbim ndaj numrit të makinave zjarrfikëse(km2 / numrit të makinave zjarrfikëse)	82.5	41.3	41.3	↓	100%

04 Çeshtjet Ekonomike



Programet buxhetore:



04220 Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve



04240 Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit



04520 Rrjeti rrugor rural



04740 Projekte Zhvillimi

Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve



Ky program zë 1.6% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave; Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore; Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve; Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë; Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë; Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural; Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit. Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës

PËRSHKRIM REALIZIMI

Aktivitetet kryesore në kuadër të këtij programi të realizuara për vitin 2019 janë: · Është bërë mbyllja dhe pyllëzimi i ish venddepozitimit të mbetjeve Mazarent me vendndodhje në fshatin Rusinjë në Njësinë Administrative Ruzhdie. · Është bërë hartimi i Planit Lokal të Menaxhimit Të Mbetjeve si pjesë e projektit Bashki të Forta në bashkëpunim me Co-Plan dhe HELVETAS. · Pastrim nga barërat, ferrat në objektin “Argjinatura e Lumit Seman” në objektin e mbjellë me ekualipt Sip.6.3 ha – 2 herë. · Vendosija e tabelave për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri në dy ekonomitë pyjore - Lumi Seman 2 - 6 tabela dhe lumi Drenie - 25 tabela. · Pastrim i rrugëve pyjore për mbrojtjen nga zjarri -26400 m2. Ngritja e skuadrave vullnetare zjarrfikse në të gjithë fshatrat të cilat kanë pyje në territorin e tyre. Ne territorin e Bashkisë Patos, rezultojnë nje thertore e licensuar, ne te cilen kryhen te gjitha therjet e certifikuara nen kopetencat e Bashkise. Gjate periudhes Janar-Dhjetor 2019 jane therur rreth 4700 gjedhe, 17000 te imta dhe 25000 derra, ku nga keto therje: Bashkia Patos ka perfituruar nje total prej afro 2,800,000 Leke. Ne territorin e Bashkise Patos nuk jane konstatuar therje ne rruge. Eshte kontrolluar dhe furnizimi i kopshteve dhe cerdheve me produkte blektorale nga firma te licensuara me produkte te garantuara · Monitorimi i buxhetit të Sektorit të Kadastrës për vitin 2019 · Në zbatim të VKM nr.994 datë 09.12.2015 janë përgatitur dhe nisur për në ASHK rreth 56 (tridhjet e gjashtë) dosje për Njësinë Patos dhe 6(gjashte) dosje për Njësinë Ruzhdie.Numri i ulët i aplikimeve lidhet me faktin pasi ka shumë mangësi në azhurnim si dhe nuk ka patur bashkëpunim nga ana e ASHK.Kemi kthyer përgjigje ASHK-së duke plotësuar dokumentacionin e kërkuar për qytetarët që kanë aplikuar për regjistrim të pasurisë tokë bujqësore për 55(pesëdhjet e pesë) shkresa për tokën bujqësore dhe 11(njëmbëdhjetë) shkresa për pjesën ALUIZNI-it për ndërtime në afërsi të brezit mbrojtës të kanaleve.Është kryer një volum i madh pune për përpunimin e dosjeve të

hapura në zbatim të VKM-së nr.337 datë 22.04.2015, arritëm të kalojmë në Këshillin Bashkiak 48 dosje, por për arsye të ndryshme, nuk u arrit të finalizohet asnjë prej tyre. Jane verifikuar ne terren, eshte mbajtur proces-verbal, eshte kthyer pergjigje me shkrim apo është dhënë informacion kryetares së bashkisë per rreth 53 (pesëdhjetë e tre) ankes-kerkesa te qytetareve per probleme me kufijte e tokes bujqesore për Njësitë Patos e Ruzhdie. Për verifikimin dhe zgjidhjen e këtyre konflikteve kemi bashkëpunuar çdo herë me kryepleqësitë e fshatrave. U bë hapja e një segmenti të rrugës së kërkuar nga disa qytetarë të lagjes Isufaj në fshatin Banaj, në ngastrën nr.50 dhe jemi në proces për lirim dhe sistemimin e gjithë gjatësisë. Janë dhënë rreth 320 vertetime qe nuk ka toke, 105 vertetime qe ka toke dhe që ushtron aktivitet bujqësor. Kemi kthyer pergjigje 10 (dhjetë) shkresave të ardhura nga Sigurimet Shoqërore Fier si dhe Dhomës së avokatëve për rastet në proces gjyqësor. Gjithashtu i jemi pergjigjur thirrjeve të Organit të Prokurorisë për dhënie shpjegime për procese të hapura nga qytetarë të bashkisë për pronën tokë bujqësore.

04220-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	3,331	2,904	8,692	6,067	108.9%	69.8%
Kapitale	0	99	3,065	1,465	1379.8%	47.8%
Total	3,331	3,003	11,757	7,532	150.8%	64.1%

PROJEKTET E PROGRAMIT

Projekte me financim të brendshëm:

Projekti	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projekti	Buxheti 2019	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	% e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019)	Komente
Transport ngarkim Zhavor shtrim/rikonstruksionrrugeve bujqesore	-	-	-	3,935	3,065	-	-	

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Sipërfaqe pyjore e dhënë me qira (në ha)	0	3.2	3.2	100.0%

Sipërfaqe pyjore në të cilën është shtuar pyllëzimi (në ha)	6.3	10	6.3	63.0%
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor (në ha)	771.2	771.2	771.8	100.1%
Aktivite për informimin dhe edukimin e mbrojtjes së mjedisit	0	16	16	100.0%
Kontrolle dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullosor	12	12	12	100.0%
Numri stafit	13	13	13	100.0%

QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqesore si dhe të kategorive të resurseve të tjera

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i shërbimit pyjor dhe kullosor

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit (Numri i aktiviteteve të ndërmarra me fokus mbrojtjen e mjedisit)	0	16	16	↑	100%
Sipërfaqe pyjore ku është shtuar pyllëzimi (Sipërfaqe pyjore ku është shtuar pyllëzimi (në ha))	6.3	10	6.3	=	63%
Rritja e kapaciteteve të punonjësve për inspektime (Numër inspektimesh për punonjës)	0.9	0.9	0.9	=	100%
Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullosor (Numri i punonjësve kundrejt fondit pyjor dhe kullosor (punonjës për 100 ha pyje dhe kullota))	1.7	1.7	1.7	=	100%

Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullosor(Numër inspektimesh për 100 ha)	1.6	1.6	1.6	=	100%
--	-----	-----	-----	---	------

Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit



Ky program zë 2.4% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

PËRSHKRIM REALIZIMI

Në transfertën specifike të vitit 2019, janë fondet për ujitjen dhe kullimin me një vlerë totale prej 19,790 mijë lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

04240-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	14,314	5,917	10,590	7,578	28.1%	71.6%
Kapitale	0	0	9,201	3,884	-	42.2%
Total	14,314	5,917	19,791	11,462	93.7%	57.9%

PROJEKTET E PROGRAMIT
Projekte me financim të brendshëm:

Projekti	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projekti	Buxheti 2019	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	% e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019)	Komente
Rehabilitim I rrjetit ujites 400 ml,ne fshatin Beline	3,889	-	-	-	3,889	3,884	100%	

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Parcela të shtruara me inerte	0	24.4	27	110.7%
Tombino të vendosura	160	80	168	210.0%
Volumi i dherave në total (në m3)	123,000	91,000	90,871.4	99.9%
Volumi i dherave të lëvizura (në m3)	32,000	39,000	32,713.7	83.9%
Kanal kullues në total (në km)	164.1	164.1	164.1	100.0%
Shtim i sipërfaqes bujqësore të mbuluar me kullim (në ha)	150	150	150	100.0%
Shtim i sipërfaqes bujqësore të mbuluar me ujitje (në ha)	400	200	11	5.5%
Kanale kullues të pastruar/mirëmbajtur (në km)	25.3	30	23	76.7%
Kanal ujitës i pastruar/ mirëmbajtur dhe përmirësuar në km	1.6	10	0.6	6.0%
